VENDIM
Nr. 652, datë 3.11.2021

PËR PËRDORIMIN E MJETEVE LËVIZËSE MOTORIKE DHE TË MJETEVE TË BLINDUARA PËR SHËRBIME TË VEÇANTA TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË E PËRCAKTIMIN E NGJYRËS DHE TË SHENJAVE DALLUESE TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 62, të ligjit nr. 33/2021, "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjetet e transportit në përdorim të Gardës së Republikës janë mjete të uniformuara dhe jo të uniformuara, të cilat klasifikohen në:

a) mjete rrugore;

b) mjete lundruese;

c) mjete ajrore.

2. Mjetet e uniformuara në përdorim të Gardës së Republikës përbëhen nga:

a) ngjyra dhe shenja dalluese, të përcaktuara sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) sisteme shtesë zanore për alarmin dhe sisteme shtesë për sinjalizimin pamor;

c) targat e mjeteve rrugore, të përcaktuara për mjetet e Ministrisë së Brendshme, sipas akteve ligjore në fuqi.

3. Mjetet e pauniformuara kanë në përbërje sisteme portative, të sinjalizimit pamor dhe zanor të alarmit.

4. Përdorimi i mjeteve lëvizëse motorike dhe i mjeteve të blinduara për shërbime të veçanta kryhet sipas përcaktimeve të lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Ngjyra, logoja dhe disenjoja në mjetet e Gardës së Republikës janë unike dhe me të drejtë përdorimi vetëm nga Garda e Republikës së Shqipërisë.

6. Të gjitha mjetet janë të kompletuara me pajisje speciale për sigurimin e jetës e realizimin e detyrës.

7. Garda e Republikës, për shërbime të veçanta, përdor mjete lëvizëse të blinduara.

8. Numri limit i mjeteve, afati përdorimit të tyre dhe limiti vjetor kilometrik miratohen me urdhër të ministrit të Brendshëm.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1

NGJYRA DHE SHENJAT DALLUESE TË UNIFORMUARA TË GARDËS SË REPUBLIKËS

I. Karakteristikat e mjeteve të tipit autoveturë janë, si më poshtë vijojnë:

1. Ngjyra e automjetit është e zezë. Ka në përbërje një shirit të kuq me material adeziv fosforeshent, që fillon nga pjesa e përparme dhe përfundon në pjesën e pasme, në kufi me portën e bagazhit, ku ndërpritet nga mbishkrimin "GARDA", me material adeziv fosforeshent të ngjyrës së verdhë. Në pjesën e sipërme, në tavan, fenelinë profesionale pamore e gjatë, me ndriçim led, me ngjyra të kuqe/të bardhë/blu dhe e kompletuar me blice përpara në maskarino dhe në pjesën e pasme brenda portës së bagazhit. Automjeti është i kompletuar me sistemet zanore shtesë të alarmit.

II. Karakteristikat e mjeteve të tipit autoveturë me kalueshmëri të lartë janë, si më poshtë vijon:

1. Ngjyra e automjetit e zezë.
2. Shirit i kuq me material adeziv fosforeshent, që fillon nga pjesa e përparme dhe përfundon në pjesën e pasme, në kufi me portën e bagazhit, ku ndërpritet nga mbishkrimi "GARDA", me material adeziv fosforeshent me ngjyrë të verdhë.
3. Në pjesën e pasme mbishkrimi "GARDA" përbëhet nga materiali adeziv fosforeshent me ngjyrë të bardhë, ku shoqërohet me viza të ndërprera me material adeziv me ngjyrë të kuqe.
4. Në pjesën e sipërme në tavan ka fenelinë profesionale pamore të gjatë, me ndriçim led, me ngjyra të kuqe/të bardhë/blu dhe e kompletuar me blice përpara në maskarino dhe në pjesën e pasme brenda portës së bagazhit.
5. I kompletuar me sistemet zanore shtesë të alarmit.

III. Karakteristikat e mjeteve të tipit autobus për transport, janë si më poshtë vijojnë:

1. Ngjyra e automjetit e zezë.

2. Shirit i kuq me material adeziv fosforeshent që fillon nga pjesa e përparme dhe përfundon në pjesën e pasme, në kufi me portën e bagazhit, ku ndërpritet nga mbishkrimi "GARDA", me material adeziv fosforeshent me ngjyrë të verdhë.

3. Në pjesën e sipërme përpara ka fenelinë profesionale pamore të gjatë, me ndriçim led, me ngjyra të kuqe/të bardhë/blu ose e kompletuar me blice përpara në maskarino.

4. Autobusi për transport është kompletuar me sistemet zanore shtesë të alarmit.

IV. Karakteristikat e mjeteve të tipit motomjet ceremoniali janë, si më poshtë vijon:

1. Ngjyra e motomjetit e bardhë.

2. Elemente të stemës së Gardës së Republikës me material adeziv fosforeshent ngjyrë GOLD, në xhamin parapritës, shoqëruar me mbishkrimin "GARDA" me ngjyrë të bardhë.

3. Në pjesën e pasme, çantat anësore, mbishkrimi "GARDA" me ngjyrë të zezë fosforeshente, ku poshtë mbishkrimit shoqërohet me 2 (dy) viza të pandërprera me material adeziv fosforeshent me ngjyrë të kuqe.

4. I kompletuar me sisteme zanore shtesë të alarmit dhe sisteme shtesë të sinjalizimit pamor.

V. Karakteristikat e mjeteve të tipit mjet lundrues, janë si më poshtë vijojnë:

1. Ngjyra e mjetit lundrues e bardhë.
2. Flamuri kombëtar me përmasa 140 x 70 cm në pjesën e sipërme, në vendin më të dukshëm.
3. Dy shirita të kuq, që fillojnë nga pjesa e përparme dhe përfundojnë në pjesën e pasme, ku njëri ndërpritet nga mbishkrimi "GARDA" me material adeziv fosforeshent me ngjyrë të zezë.
4. I kompletuar me pajisje sipas përcaktimeve në Kodin Detar të Republikës së Shqipërisë.

Lidhja nr. 2

PËRDORIMI I MJETEVE LËVIZËSE MOTORIKE DHE I MJETEVE TË BLINDUARA PËR SHËRBIME TË VEÇANTA

Nr.	Klasifikimi	Lloji	Përdorimi
1	Automjete	Autoveturë	Automjet me një aks aktiv, për transportin e punonjësve që ruajnë dhe sigurojnë Personalitetet e Larta Shtetërore dhe Personalitetet Shtetërore të vendit apo të huaja, i pajisur me sisteme të sigurisë sipas standardeve të kohës, me fuqi të konsiderueshme motorike, që t'i përgjigjet ecjes dhe regjimit në eskortë.
		Autoveturë	Automjet me dy akse aktive, me kalueshmëri të lartë, për transportin e punonjësve që ruajnë dhe sigurojnë Personalitetet e Larta Shtetërore dhe Personalitetet Shtetërore të vendit apo të huaja, i pajisur me sisteme të sigurisë sipas standardeve të kohës, me fuqi të konsiderueshme motorike, që t'i përgjigjet ecjes dhe regjimit në eskortë.
		Autoveturë	Automjet, me një ose dy akse aktive, që përdoret për shërbime të tjera në strukturat e Gardës së Republikës.
		Autobus	Automjet me një ose dy akse aktive, që përdoret për transport punonjësish në shërbime të ndryshme për sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore dhe Personaliteteve Shtetërore të vendit apo të huaja.
		Kamion	Përdoret për shërbimet mbështetëse.
		Automjet për transport të veçantë (autoambulancë, autofiçinë, tërheqës, autobot, shihedhës etj.)	Për shërbime të ndryshme në përmbushje të detyrave të Gardës së Republikës, në varësi të situatave të caktuara.
		Automjet për përdorim të veçantë Mjete speciale për instalim dhe transport pajisjesh të veçanta	Përdoret për shërbime të veçanta në Gardën e Republikës.
		Automjet për përdorim të veçantë (automjet i blinduar)	Përdoret për shoqërim dhe evakuim personalitetesh.
		Automjet për përdorim të veçantë (transportues i blinduar me rrota)	Përdoren nga strukturat speciale në Gardën e Republikës për evakuim personalitetesh.
2	Motomjete	Motorë	Përdoren për shërbimet e ceremonialit me delegacionet.
		Motorë	Përdoren për shërbimet të tjera të Gardës, si: posta, grupe të gatshme, etj.
3	Motoagregate	Gjeneratorë ndriçimi i lëvizshëm/stacionar	Për shërbimet mbështetëse në aktivitete të ndryshme apo për mbajtjen në gatishmëri të objekteve të rëndësisë së veçantë.

4	Mjete lundruese	Gomone/skaf	Për shërbimet e ruajtjes dhe sigurisë së Personaliteteve të Larta Shtetërore, Personaliteteve Shtetërore të vendit apo të huaja, të pajisur me sisteme navigimi dhe lundrimi të sigurisë sipas standardeve të kohës.
5	Mjete ajrore	Helikopter	Për shërbimet e ruajtjes dhe sigurisë së Personaliteteve të Larta Shtetërore, Personaliteteve Shtetërore të vendit apo të huaja, të pajisur me sisteme navigimi dhe lundrimi të sigurisë sipas standardeve të kohës.
6	Makina teknologjike	Autopirun, autovinç	Për shërbimet mbështetëse.